



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

.....Numri i lëndës: 2023:200898

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05802361

PAKR.nr.254/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Albulena Rexha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.Z., nga fshati, Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale të vrasjes nga neni 172 të KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar M.G.B., av.Blerim Mazreku dhe ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit I.Z., av.Asman Hoxha, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.8/2024, të dt.11.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.06.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat, e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar M.G.B., av.Blerim Mazreku dhe mbrojtësit së të akuzuarit I.Z., av.Asman Hoxha, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.8/2024, të dt.11.03.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.8/2024, të dt.11.03.2024, është shpallur fajtor i akuzuari I.Z., për shkak të veprës penale të vrasjes nga neni 172 të KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPK, ashtu që:

-për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjetë) viteve,

-për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj.

Në kuptim të nenit 76 par.1 lidhur me par.2 pika 2.2 të KPK, i është shqiptuar dënimi me burgim unik në kohëzgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjetë) vite.

Në dënimin e shqiptuar me burgim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.20.09.2023, e gjerë në përfundim të dënimit të shqiptuar.

Të akuzuarit I.Z., i është konfiskuar arma e tipit “Sig-Suer-P320”, me nr.serik 58H075982, 57 fishek të kal.9x19mm, në dy pako, një karikator me shtatë fishek e kal.9x19mm, sipas listës së armëve të sekuestruara me numër të rastit 2023-ED-528, si objekt i kryerjes së veprës penale.

Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit ana e konfiskuar duhet të shkatërrohet, po qesë e njëjta nuk është involvuar në ndonjë rast tjetër.

Është obliguar i akuzuari I.Z., që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 50 Euro, si dhe shumën prej 50 Euro, në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarit M.G.B., E.B. O.B. dhe A.B., që të gjithë nga fshati, Komuna e Suharekës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Gjakovë, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.8/2024, i dt.11.03.2024, të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i ashpër,

-përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuara M.G.B., av.Blerim Mazreku, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit, ti shqiptohet dënim më i ashpër, për veprat penale të cilat i vihen në barrë, si dhe

-mbrojtësi i të akuzuarit I.Z., av.Asman Hoxha, për shkak vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë, për të dy veprat penale të cilat i vihen në barrë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.235/2024, të datës 30.04.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar M.G.B., av.Blerim Mazreku, ka propozuar që të njëjtat të aprovohen si të bazuara, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.8/2024, i dt.11.03.2024, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i ashpër, kurse sa i përket ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit I.Z., av.Asman Hoxha, e njëjta të refuzohet si e pa bazuar.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.06.06.2024, dhe i ka njoftuar në mënyrë të rregullt të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i akuzuari I.Z., i cili është sjellë nga ana e qendrës së paraburgimit, mbrojtësi i të akuzuarit, av.Asman Hoxha, e dëmtuara M.G.B., së bashku me përfaqësuesin e autorizuar, av.Blerim Mazreku, ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, si dhe të dëmtuarit E.B. O.B. dhe A.B., përkundër asaj që kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.Z., av.Asman Hoxha, ka deklaruar se ngel pranë ankesës së ushtruar, dhe ka propozuar që vendimi për dënimin të ndryshohet, të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim më i butë, për të dy veprat penale, të cilat i vihen në barrë, pasi që i njëjti edhe e ka pranuar fajësinë.

I akuzuari I.Z., ka deklaruar se ngel pranë pretendimeve ankimore, si dhe paraqitjes së mbrojtësit av.Asman Hoxha.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar M.G.B., av.Blerim Mazreku, ka ngelur pranë ankesës së ushtruar dhe ka propozuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër për veprat penale të cilat i ka kryer.

E dëmtuara M.G.B., ka deklaruar se e mbështet fjalën e përfaqësuesit të autorizuar, av.Blerim Mazreku.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar M.G.B., av.Blerim Mazreku, si dhe mbrojtësit së të akuzuarit I.Z., av.Asman Hoxha, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, aktgjykimit të ankimuar, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesat, e Prokurorisë Themelore, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar M.G.B., av.Blerim Mazreku, si dhe mbrojtësit së të akuzuarit I.Z., av.Asman Hoxha, nuk janë të bazuara

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkalës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kolegji i kësaj gjykate e ka shqyrtuar aktgjykimin si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara në kuptim të nenit 384 të KPPK, për të cilat shkelje kolegji i Gjykatës së Apelit, përkujdeset sipas detyrës zyrtare në pajtim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe shkeljet e ligjit penal, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje panel ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë, nga ana e të akuzuarit, është bërë në pajtim me të gjitha dispozitat përkatëse ligjore, e po ashtu ka pasur parasysh se i akuzuari ka pasur sjellje të mira në gjykatë, se është i martuar, baba i dy fëmijëve, se është penduar për veprat e kryera penale, se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese e sidomos ka pasur parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, të cilat rrethana kanë qenë të ashpra, pasi që nga ana e të akuzuarit, i dëmtuari është goditur pesë herë në kokë dhe dy herë në trup, që nënkupton me shtatë plumba, atëherë parashtrohet pyetja se mos janë mbi vlerësuar rrethanat lehtësuese të cilat çfarëdo qofshin në këtë çështje penale, nuk është dashur që të kenë parasysh, sepse me dënimin e shqiptuar nuk pritet që të arrihet efekti dhe qëllim i dënimit të shqiptuar.

Përfaqësuesit i autorizuar i palës së dëmtuar M.G.B., av.Blerim Mazreku, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se në këtë çështje penale rezulton se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, se ka pasur sjellje korrekte në gjykatë si dhe rrethanat personale të akuzuarit, të cilat çfarëdo qofshin nuk është dashur që të mbivlerësohen sepse dënimi i shqiptuar të akuzuarit, me burgim në kohëzgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjetë) viteve, nuk është në proporcion me veprat e kryera penale.

Në këtë çështje penale duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes së të njëjtëve, dhe dashjen për të kryer këto vepra penale nga ana e të akuzuarit, jemi të mendimit se dënimi i shqiptuar është i butë, përkatësisht i ulët dhe me këtë lloj dënimi nuk pritet që të arrihet efekti dhe qëllimi i tij. Këto gjykata e shkallës së parë është dashur ti ketë parasysh e sidomos edhe rrethanën se këtu i ndjeri me të akuzuarin kanë pasur raporte shumë të mira, në më shumë se dhjetë vite, se kanë qenë koleg të punës, andaj me këtë lloj dënimi nuk pritet që të arrihet efekti dhe qëllimi i tij.

Po ashtu ankesë për shkak të vendimit me sanksionin penal, ka ushtruar edhe mbrojtës i i të akuzuarit I.Z., av.Asman Hoxha, duke pretendua se në këtë çështje penale për veprën penale të vrasjes nga neni 172 të KPK, i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjetë) viteve, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPK, i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve e 6 (gjashtë) muaj, kurse në kuptim të dispozitës përkatëse ligjore, i

është shqiptuar dënimi me burgim unik në kohëzgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjetë) vite, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.20.09.2023, jemi të mendimit se dënimi është i ashpër, e sidomos duke pasur parasysh rrethanat sikurse ato lehtësuese, po ashtu edhe ato rënduese.

Si rrethanë lehtësuese gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se i akuzuari ka pasur sjellje korrekte në gjykatë, se ka bashkëpunuar me organet në çdo fazë të procedurës, sikurse parashohin dispozitat ligjore nga neni 69 lidhur me nenin 70 të KPK, se i njëjti është i martuar, baba i dy fëmijëve, se ka shpreh keqardhje për veprën e kryer penale, si dhe është penduar për kryerjen e të njëjtës, andaj duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana jemi të mendimit se me këtë lloj dënimi, nuk mund të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, i paraparë me dispozitën përkatëse ligjore, nga neni 38 i KPK.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me ankesat e ushtruara, e prokurorisë si dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar M.G.B., av.Blerim Mazreku, përkitazi me vendimin për dënimin, ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit I.Z., av.Asman Hoxha, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës, e sidomos nga pranimi i fajësisë, nga ana e të akuzuarit, si dhe të gjitha provave të tjera, personale dhe materiale nga shkresat e lëndës, ashtu që kolegji ka vlerësuar se nga ana e gjykatës së shkallës së parë, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin e caktimit dhe llojit të lartësisë së tij, nga ana e gjykatës janë vlerësuar të gjitha rrethanat sikurse lehtësuese po ashtu ato rënduese, të parapara në nenin 69 lidhur me nenin 70 të KPK. Si rrethana lehtësuese ka vlerësuar se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, të cilin pranim e ka bërë gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të procedurës, ka vlerësuar se i akuzuari I.Z., ka pasur sjellje korrekte në polici, prokurori dhe gjykatë, se i njëjti është i martuar, baba i dy fëmijëve, se është penduar për veprat e kryera penale, se më parë nuk ka qenë i dënuar, kurse ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, e sidomos dashjen për të kryer veprat penale, që bjen në kuadër të mënyrës së kryerjes së të njëjtave, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtave.

Nga ana e ankesave të ushtruara, ajo nga ana e prokurorisë, si dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, av.Blerim Mazreku, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, e po ashtu edhe nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit I.Z., av.Asman Hoxha, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, ashtu që kolegji i kësaj gjykate duke vlerësuar çështjen penale si tërësi, ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim unik me burgim, sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe duke qenë i bindur se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin

shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Të gjitha vendimet e marra në këtë çështje penale e kanë mbështetjen e duhur ligjore, sikurse janë vendimet për dënimin, konfiskimin e sendeve pas kryerjes së veprave penale, shpenzimet procedurale, kompensimi i viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.254/2024, të datës 06.06.2024

Procesmbajtësja,
Albulena Rexha

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Zyhdi Haziri